



Arrestohen tre persona të dyshuar si pjesë e një grupi kriminal,
policia gjen drogë, armë e municion

LAJME



30/10/2022 10:49

**Policia e Kosovës ka arrestuar tre persona të dyshuar si pjesë e një grupi kriminal.**

Sipas njoftimit të policisë, pas hetimeve disa mujore të rastit të koduar me emrin "Bardhoshi-2", dje rreth orës 16:30 në autostradën Prishtinë-Prizren në fshatin Reshtan të komunës së Suharekës, policia ka arritur të ndalojë veturën e dyshuar të tipit "Mercedes", e cila drejtohej nga njëri i dyshuar me inicialet K.P., dhe pasagjeri i dyshuar me inicialet D.K., shkruan lajmi.net.

Policia ka bërë të ditur se pas kontrollit në veturë është gjetur sasi e konsiderueshme e substancave narkotike.

"Pas kontrollit të automjetit në cilësi të provës material janë gjetur dhe sekuestruar: 30.3 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit Kokainë, 768.2 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit Marihuanë, dy telefona celular, një mulli (grinder) i cili përdoret për bluarje të marihuanaës dhe të holla me vlerë 43.10 euro", thuhet në njoftim.

Të tre të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për procedura të mëtejme ligjore.

Më poshtë gjeni njoftimin e plotë të policisë dhe detajet nga aksioni:

Policia e Kosovës, konkretisht hetuesit e antidrogës nga rajoni i Prishtinës të asistuar nga njësitë i antidrogës në Prizren pas hetimeve disa mujore të rastit të koduar me emrin “Bardhoshi-2”, më datë 29.10.2022, rreth orës 16:30 në autostradën Prishtinë-Prizren në fshatin Reshtan të komunës së Suharekës, kanë arrit të ndalojnë veturën e dyshuar të tipit Mercedes, ngjyrë e zezë, me targa vendore të cilën e drejtonte i dyshuari me iniciale (K. P.) dhe pasagjer ishte i dyshuari tjetër (D. K.).

Pas kontrollit të automjetit në cilësi të provës material janë gjetur dhe sekuestruar: 30.3 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit Kokainë, 768.2 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit Marihuanë, dy telefona celular, një mulli (grinder) i cili përdoret për bluarje të marihuanaës dhe të holla me vlerë 43.10 euro.

Në vazhden e hetimit të këtij rasti me urdhër të Prokurorit kujdestar, nga njësit rajonal i antidrogës në Prishtinë është realizuar kontrollë tjetër në objektet e banimit dhe objektet përcjellëse të të dyshuarve në rrugën “Muharrem Fejza”, rr.“Ahmet Gashi” dhe rr.“Muhamet Çame” adresa të gjitha në Prishtinë dhe në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar dëshmitë si në vijim:

– Në rrugën “Muharrem Fejza” në vendbanimin (shtëpinë) e të dyshuarit (D. K.), janë sekuestruar: 1525.5 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanaë, një armë zjarri me gaz, një peshore digjitale dhe 160 euro para kesh të dyshuara të jenë falco.

– Në rr.“Muhamet Qame” në vendbanimin (banesën) e të dyshuarit (E. H.) janë sekuestruar: 711.6 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuana, një peshore digjitale dhe një telefon celular.

– Në rr.“Ahmet Gashi” në banesën e të dyshuarit (K. P.) janë sekuestruar: 688.4 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanaë, një tabletë narkotike e dyshuar e llojit EXTASY, dy peshore digjitale, një armë e gjatë AK 47 me dy karrikator dhe 38 fishekë, një armë e gjatë (pushkë) me 5 fishekë dhe 11 fishekë tjerë, etj.

Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate


- (3693.7) gram substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanë
- (105.7) gram substancë e dyshuar narkotike e llojit kokainë
- (1) tabletë e dyshuar për narkotik të llojit EXTASY
- (3) armë zjarri
- (2) karikatorë
- (54) fishekë
- (1993.10) euro
- (200) lek
- (30) franga
- (30) funta
- (1) dollar
- (3) telefona celular
- (1) veturë
- (6) peshore digjitale
- (3) mullinjë (grindera)

Pas kompletimit të rastit me vendim të Prokurorit kompetent tre (3) personat e dyshuar dërgohen në mbajtje për proceduar të mëtejme ligjore.


Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin e dukurive negative dhe veprave penale në përgjithësi, në veçanti luftë e pakompromis do të zhvillohet kundër individëve dhe grupeve kriminale që merren me abuzimin, posedimin apo shpërndarjen e substancave narkotike (drogave) që paraqesin rrezik potencial për shoqërinë, në veçanti shëndetin e të rinjve tanë. **/Lajmi.net/**



lajmi.net







Artikuj të ngjashëm



BE ka bllokuar 17 miliardë euro asete ruse

lajmi.net



Keqtrajtoi fëmijën e vet, arrestohet një nënë në Pejë



Asnjë rast me COVID-19 gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë




Çmimet e derivateve për sot dhe nesër



Sulmoi prindërit e vet, kërkohet nga policia



LAJME TË FUNDIT



Atletico me plan të qartë – Simeone deri në vitin 2026



E dëshpëruar nga shteti të cilin po e...



Kjo është këngëtarja shqiptare me të cilën Lluni...



BE ka bllokuar 17 miliardë euro asete ruse



lajmi.net



lajmi.net

info@lajmi.net

Tel: +383 49 131 131

Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

[Fact-Checking Policy](#)

[Ethics Policy](#)

[Corrections Policy](#)

[Ownership & Funding Information](#)

[Editorial Team Information](#)

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved [Privacy Policy](#)